



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë-Kosovë, Luan Haradinaj p.n.
e-mail: contact@pallatirinise.com
socialmedia@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Nr. 1/332 Dt. 24.02.2026

Në bazë të nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 130 të Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë Tregtare si dhe në bazë të Statutit të Ndërmarrjes, Bordi i Drejtorëve të N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A., në mbledhjen e mbajtur me datë 24.02.2026 miraton këtë,

RREGULLORE PËR MARKETING NË NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE “PALLATI I RINISË” SH.A.

KREU I DISPOZITAT THEMELORE E drejta ekskluzive komerciale

1. Të gjitha të drejtat komerciale dhe reklamuese brenda objektit i takojnë ekskluzivisht N.P.L. “Pallati i Rinisë” Sh.a.
2. Asnjë klub sportiv, organizator eventit apo palë e tretë nuk ka të drejtë të shesë, japë me qira, ndërmjetësojë apo disponojë hapësira reklamuese pa autorizim të shkruar nga Ndërmarrja.

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim të rregullojë kushtet, procedurat dhe kriteret për vendosjen, shfaqjen dhe menaxhimin e materialeve të marketingut dhe reklamimit brenda hapësirave të Pallatit të Rinisë, me synim ruajtjen e sigurisë, estetikës, funksionalitetit dhe interesit publik, dhe mbrojtjen e tij si pjesë e trashëgimisë kulturore. Aktivitetet e Marketingut dhe reklamimit nuk guxojnë të çenojnë misionin publik, kulturor dhe sportiv të Pallatit të Rinisë.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për të gjitha subjektet juridike dhe fizike që kërkojnë të shfrytëzojnë hapësirat e dedikuara për marketing dhe promocion në Pallatin e Rinisë, përfshirë bizneset, sponsorët, organizatorët e eventeve dhe institucionet.

KREU II
PËRKUFIZIMI I SHPREHJEVE

Neni 3
Termet kryesorë

1. Marketing/Promocion – çdo formë promovimi vizual, audio, digjital ose fizik.
2. Material reklamues – postera, banera, roll-up, ekrane LED, reklama digjitale, logo, video etj.
3. Hapësira e përbashkët – hyrje, korridore, shkallë, salla, zona pritjeje.
4. Subjekt reklamues – personi fizik ose juridik që aplikon për reklamim.
5. Zyra për Marrëdhënie me Klient, marketing dhe promocion– Njësia përgjegjëse e Pallatit të Rinisë për menaxhimin e marketingut.
6. Reklamë politike – çdo reklamë që promovon parti, kandidatë ose iniciativa politike.
7. Reklamë e përkohshme – reklamë për një periudhë të caktuar ose event specifik.
8. Hapësirat reklamuese – nënkupton hapësirën e lejuar për marketing.
9. Tarifat – nënkupton listën zyrtare të çmimeve për shërbimet e marketingut.
10. Personi juridik dhe fizik – nënkupton individin ose biznesin i cili bën kërkesë për shfrytëzim të hapësirës reklamuese.
11. Rotacion – Nënkupton një cikël të plotë të transmetimit të të gjitha materialeve reklamuese të programuara në LED ekran.
12. LED/LCD EKRAN – nënkupton ekranin elektronik digjital të instaluar në hapësirat e Ndërmarrjes.

KREU III
KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 4
Parimet bazë

4.1 Vendorsja e materialeve reklamuese dhe të marketingut në hapësirat e N.P.L. “Pallati i Rinisë” Sh.a. duhet të përmbushë këto parime:

- 4.1.1 Të jetë e autorizuar paraprakisht nga organi kompetent i ndërmarrjes;
- 4.1.2 Të mos pengojë qarkullimin e lirë të vizitorëve dhe daljet emergjente;

- 4.1.3 Të mos cenohet sigurinë, pastërtinë, estetikën dhe funksionalitetin e objektit;
 - 4.1.4 Të mos përmbajë përmbajtje politike, diskriminuese, mashtruese, të pahijshme apo që nxit urrejtje ose ekstremizëm;
 - 4.1.5 Të mos cenohet imazhin institucional dhe misionin publik, kulturor dhe sportiv të Pallatit të Rinisë;
 - 4.1.6 Të mos shkaktojë dëmtim të objektit ose pajisjeve;
 - 4.1.7 Të mos përdorë pajisje me zhurmë pa autorizim paraprak;
 - 4.1.8 Të jetë në përputhje me standardet teknike dhe hapësinore të objektit;
- 4.2 Ndalohet realizimi i marketingut nga subjekte që janë në konflikt interesi, kanë detyrime të papaguara ndaj Pallatit të Rinisë ose janë nën masa ndaluese sipas marrëveshjeve kontraktuale.
- 4.3 Sistemi reklamues duhet të jetë i pajisur me mbështjellës, për të parandaluar lëndimin e lojtarëve dhe duhet të vendoset në mënyrën e përshkruar në këtë rregullore, që të mos pengojë qarkullimin dhe komunikimin e lojtarëve dhe gjyqtarëve me banka, tavolinë zyrtare dhe fushë të lojës.

Neni 5

Përgjegjësia e subjektit

- 5.1 Në rast të lidhjes së kontratës për dhënie me qira të hapsirës në LED ekran për kohë të caktuar, subjekti ka këto përgjegjësi:
- Përmbajtjen e materialit reklamues;
 - Të drejtat e autorit;
 - Përdorimin e logos, markës apo materialeve të treta.

Neni 6

Paraqitja e kërkesës

- 6.1 Kërkesa mund të paraqitet në formë elektronike dhe fizike dhe përmbanë dokumentacionin përkatës:
- 6.1.1 Nëse është person juridik:
- Çertifikatën e biznesit;
 - Kopja e letërnjoftimit të pronarit;
 - Kohëzgjatjen e shfrytëzimit;
 - Materialin;
 - Vendndodhjen e reklamës;
- 6.1.2 Nëse është person fizik:
- Kopja e letërnjoftimit të personit fizik;
 - Kohëzgjatjen e shfrytëzimit;

- Materialin;
- Vendndodhjen e reklamës.

Neni 7

Obligimet e N.P.L. "Pallati i Rinisë" Sh.a. ndaj subjektit reklamues

- 7.1 N.P.L. "Pallati i Rinisë" Sh.a. obligohet që të sigurojë hapësirën e kontraktuar për gjatë gjithë kohëzgjatjes së përcaktuar në kontratën përkatëse, materialet e marketingut dhe reklamimit të miratuara dhe të kontraktuara t'i publikojë dhe ekspozojë gjatë gjithë kohëzgjatjes së përcaktuar në kontratën përkatëse, në përputhje me kushtet teknike dhe hapësinore të objektit.
- 7.2 Në rast se, për arsye teknike ose organizative, pamundësohet shfytëzimi i hapësirë së kontraktuar Pallati i Rinisë obligohet:
- të kthejë shumën e paguar proporcionalisht me periudhën e mosrealizimit të shërbimit; ose
 - të kompensojë subjektin reklamues me shtyerje të afatit të marrëveshjes, sipas dakordimit të ndërsjellë.
- 7.3 Përjashtim nga kjo dispozitë bëjnë rastet kur mosrealizimi ndodhë për arsye sigurie, rrethana të jashtëzakonshme ose ndërprerje të aktivitetit që nuk varen nga Pallati i Rinisë.
- 7.4 Në rast të mosrealizimit të plotë të shërbimit për arsye të brendshme të Pallatit të Rinisë, kompensimi bëhet në përputhje me kushtet e kontratës së lidhur ndërmjet palëve.

Neni 8

Përgjegjësia për përmbajtjen e materialeve reklamuese

- 8.1 N.P.L. "Pallati i Rinisë" Sh.a. nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen, saktësinë, ligjshmërinë dhe vërtetësinë e pohimeve, mesazheve apo informatave të paraqitura në materialet reklamuese.
- 8.2 Përgjegjësinë e plotë juridike, morale dhe materiale për përmbajtjen e reklamave e mbanë subjekti reklamues, i cili garanton se materialet e paraqitura janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nuk cenojnë interesin publik, rendin publik, të drejtën autoriale, moralin shoqëror dhe imazhin institucional të Pallatit të Rinisë.
- 8.3 Në rast se përmbajtja e reklamës rezulton në shkelje ligjore ose dëm reputacional për Pallatin e Rinisë, subjekti reklamues obligohet të kompensojë çdo dëm të shkaktuar dhe reklama hiqet menjëherë.

Neni 9

Marketingu pa pagesë

- 9.1 Marketingu pa pagesë mund të realizohet përmes Marrëveshjes së Mirëkuptimit ose bashkëpunimit dypalësh, në raste të shkëmbimit të shërbimeve pa kompensim financiar.

- 9.2 Në çdo rotacion të shfaqjes së reklamave në ekranet LED të Ndërmarrjes rezervohen detyrimisht 10 sekonda për shfaqjen e përmbajtjes institucionale të Ndërmarrjes (logo, mesazhe zyrtare, njoftime)
- 9.3 Kjo kohë që është e rezervuar ekskluzivisht për ndërmarrjen “Pallati i Rinisë” sh.a., nuk i nënshtrohet tarifimit dhe nuk mund të ju jepet në shfrytëzim palëve të treta në asnjë formë. Menaxhimi, përzgjedhja dhe publikimi i përmbajtjes bëhet nga Ndërmarrja “Pallati i Rinisë”.
- 9.4 Në rastet kur hapësira jepet me qira për organizim event, ndërmarrja mund të përcaktojë një zonë të veçantë të kufizuar brenda sallës ku organozatorit i lejohet vendosja e materialeve promovuese pa pagesë e cila:
- Përcaktohet paraprakisht nga ndërmarrja;
 - Nuk përfshinë asnjërën nga hapësirat e kontraktuara.
- 9.4.1 Organizatorit i lejohet vendosja e materialeve reklamuese shtesë:
- Banera
 - Flamuj
 - Roll up
- 9.4.2 Organizatorit i ndalohe:
- Të vendosë materiale reklamuese në hapësirat e dedikuara për reklamim komercial nga ndërmarrja;
 - Të mbuloj logo, marka apo struktura të përhershme;
 - Të ndërhyjë në LED apo ekranin qendror;
 - Çdo vendosje pa autorizim konsiderohet shkelje kontrate dhe i jep të drejtë ndërmarrjes të bëjë largimin e menjëhershëm të materialeve.

KREU IV KONTRATAT

Neni 10

Lidhja e kontratave për marketing

- 10.1 Në përputhje me këtë Rregullore, N.P.L. “Pallati i Rinisë” Sh.a. lidh kontrata për marketing me persona fizikë dhe juridikë, përfshirë biznese, institucione, organizata dhe sponsorë.
- 10.2 Kontratat mund të jenë afatshkurtra (nga 1 ditë) ose afatgjata (deri 1 vit maksimum) varësisht nga natyra e aktivitetit dhe marrëveshjes së arritur.
- 10.3 Pjesë përbërëse e kontratës është edhe lista zyrtare e tarifave të marketingut dhe kushtet teknike të realizimit.
- 10.4 Afati i kontratës mund të vazhdohet me kërkesë të arsyetuar nga subjekti nëse e njëjta hapësirë është e lirë dhe miratohet nga Zyra për Marrëdhënie me Klient, Marketing dhe promocion e Pallatit të Rinisë.

10.5 Hapësira reklamuese e kontraktuar nuk lejohet të nënkontraktohet. Në rast të kërkesave të shumta për të njëjtën periudhë, prioritet ka subjekti që ka aplikuar i pari dhe ka përmbushur kushtet financiar.

Neni 11

11.1 Pallati i Rinisë rezervon të drejtën të pezullojë ose refuzojë ofrimin e shërbimeve të marketingut ndaj subjekteve që nuk përmbushin obligimet kontraktuale.

11.2 Subjektet që shkelin në mënyrë të përsëritur marrëveshjet kontraktuale mund të përjashtohen nga aplikimet e ardhshme për marketing.

Neni 12

12.1 Afatet dhe kushtet e pagesës përcaktohen në kontratë, sipas kësaj rregulloreje.

Neni 13

Tarifat e marketingut

13.1 Tarifat përcaktohen sipas:

Tabela e tarifave bashkëlidhet si Aneks i kësaj Rregulloreje.

Neni 14

Marketingu Digjital

14.1 N.P.L. "Pallati i Rinisë" realizon aktivitete marketingu edhe përmes platformave digjitale, përfshirë:

- Webfaqen zyrtare
- Rrjetet sociale (Facebook, Instagram, TikTok, LinkedIn, etj.)
- Newsletter / buletin elektronik
- Email marketing
- Sponsorime dhe reklama online

Neni 15

15.1 Zonat e lejuara Marketingu lejohet vetëm në hapsirat e përcaktuara sipas rregullorës:
Klasifikimi i zonave reklamuese

15.1.1 Hapësirat reklamuese në objektin e ndërmarrjes ndahen në 3 kategori kryesore:

- Zona e qendrës tregtare

- Zona sportive
- Zona multifunkionale / qendra rinore

15.1.2 Zona e qendrës tregtare:

- Karakter: komercial i përgjithshëm
- Orari: 07:00-23:00
- Tarifa: ditore/javore/mujore/vjetore /sipas rotacionit
- Përfshinë ekranet në tri hyrjet kryesore të qendrës

15.1.3 Zona sportive:

- Karakter: sportiv ,
- Orari: Aktivizohet gjatë ndeshjeve
- Tarifa: sipas ndeshjeve/sekondave/paketës

15.1.4 Përfshihet qendra e fushës, tribunat, LED-et rrethues, ekrani qëndror anash tabelës së rezultatit duke u ndarë me zona :

- Zona A –Tabela e Rezultateve
- Zona B- LED rreth fushës
- Zona C – LED rrethues në Tribuna
- Zona D – Qendra e fushës/laser digjital (3D projection mapping)

15.1.5 Zona Multifunkionale /qendra rinore:

- Karakter: kulturor, sportiv, edukativ, institucional, komercial
- Tarifa: orë/ditë

KREU V

DISPOZITAT NDËSHKUESE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Mbikëqyrja

16. Përgjegjës për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregullore është Kryeshefi Ekzekutiv dhe departamentet përkatëse.

Neni 17





Masat ndëshkimore

17.1 Subjekti juridik apo fizik që vendos materiale reklamuese në hapësirat e Pallatit të Rinisë pa leje paraprake ose pas skadimit të afatit të lejes, i nënshtrohet penaltetit financiar sipas vleres së kontratës. si dhe largimit të menjëhershëm të materialit.

Neni 18
Hyrja në fuqi

18.1. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i Ndërmarrjes Publike
“Pallati i Rinisë“ Sh.a.

MIRATUAR NGA BORDI I DREJTOREVE:

Ariana Pireva – Kryesuese 
Gani Sopi – Anëtar 
Vjosa Rrahmani – Anëtare 
Shuajb Mehmeti – Anëtar 



ANEKS I

TARIFAT ZYRTARE TË MARKETINGUT

(Pjesë përbërëse e Rregullores për Marketing të N.P.L Pallati i Rinisë Sh.a.)

Çdo spot reklamues zgjatë 10 sekonda dhe përfshihet në një cikël rotacioni i cili përfshihet vazhdimisht gjatë gjithë orarit të funksionimit të ekranit

Rotacioni – Zona Sportive

1. Koha maksimale e një rotacioni gjatë ndeshjeve sportive është 90 sekonda.
2. Koha për çdo sponsor është 10 sekonda për cikël.
3. 10 sekonda në çdo cikël rezervohen për përmbajtje institucionale të Ndërmarrjes.
4. Numri maksimal i sponsorëve përcaktohet sipas formulës:

Ku,

- N = numri maksimal i sponsorëve
- T = koha totale e rotacionit (90 sek)
- P = koha e rezervuar për Pallatin (10 sek)
- S = koha për sponsor (10 sek)

“Numri maksimal i subjekteve reklamues në një rotacion përcaktohet sipas formulës:

$$N = (T - P) / S$$

Ku

T është koha totale e rotacionit,
P koha e rezervuar për përmbajtje institucionale,
S koha e shfaqjes për një sponsor.”

N = 8 sponsorë maksimal

T = 90 sek

P = 10 sek

S = 10 sek

Numri maksimal i sponsorëve është 8.

Rotacioni – Zona e Qendrës Tregtare

1. Orari i transmetimit: 07:00 – 22:00.
2. Koha për subjektet reklamues: minimum 10 sek, maksimum 20 sek.
3. Numri maksimal i sponsorëve në një rotacion nuk mund të tejkalojë 18 subjekte.
4. Struktura e rotacionit përcaktohet nga Ndërmarrja në varësi të kapacitetit.

1. PAKETAT E FAVORSHME (ZBRITJET ANUALE)

Kohëzgjatja e Kontratës	Përqindja e Zbritjes
Paketa 3 mujore	-10% Zbritje
Paketa 6 mujore	-15% Zbritje
Paketa 12 mujore	-20% Zbritje

2. TARIFAT PËR HAPËSIRAT REKLAMUESE (MUJORE DHE AKTIVITETE)

Lokacioni	Sasia	Materiali	Koha e reklamimit	Tarifat (€)
Qendra komerciale/ Zona A	3 copë	LED Panel	10s	250.00€/muaj
Qendra multifunkcionale/ qendra rinore/ Zona A	1 copë	LED Panel	Gjatë aktivitetit	100.00€/aktivitet
Qendra multifunkcionale/ qendra rinore/ Zona B	1 copë	LED Panel	Gjatë aktivitetit	100.00€/aktivitet
Zona sportive/ Zona A	1 copë	LED Panel	Gjatë ndeshjës	500.00€/ndeshje
Zona sportive/ Zona B	1 copë	LED Panel	Gjatë ndeshjës 10s - rotacion	100.00€/vendore 150.00€/ndërkombëtare 200.00/finale
Zona sportive/ Zona C	1 copë	LED Panel	Gjatë ndeshjës 10s – rotacion	150.00€/ndeshje
Zona sportive/ Zona D	1 copë	LASER	Gjatë ndeshjës 10s - rotacion	500.00€/ndeshje

Pako reklamuese	Përqindja e Zbritjes
Paketa 2 kombinime	-10% Zbritje
Paketa 3 kombinime	-15% Zbritje
Paketa 4 kombinime	-20% Zbritje

Skica për Marketing në fushë sportive

